
TOP ALBANIA SHA
K01719005H

PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2024

[ADRESA: SHESHI ITALIA, ARENA CENTER, HYRJA D, ZONA E ZYRESNR. "DC", NIVEL L+3, TIRANË]

Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra e Performancës (të ardhurave dhe shpenzimeve) sipas natyrës	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte).....	4
Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare.....	5
A. Informacion i përgjithshëm	5
B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare	5
C. Politikat kryesore kontabile.....	6
1. Transaksionet në monedhë të huaj	6
2. Instrumentat financiare.....	7
3. Inventarët.....	8
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t).....	8
5. Qiratë.....	9
6. Transaksionet me palët e lidhura	10
7. Dividendë	10
8. Kapitali i Vet.....	10
9. Grantet	10
10. Të Ardhurat dhe shpenzimet.....	10
11. Tatimi mbi fitimin	10
12. Përfitimet e punonjësve	11
13. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara	11
14. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare	11
D. Shënimet për Pozicionet Financiare.....	12
1. Mjetet Monetare	12
2. Të drejta të arkëtueshme	12
3. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	12
4. Aktive Afatgjata Materiale dhe Jomateriale	13
5. Detyrime Afatshkurtra.....	14
6. Detyrime për Hua	14
7. Kapitali	14
8. Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit	15
9. Shpenzimet e personelit	15
10. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	15
11. Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit	15
12. Shpenzime financiare.....	16
13. Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor	16
14. Palët e lidhura	16
15. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	17
16. Kontrollë tatimore	17
17. Ngjarje pas datës së bilancit	17


Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënimet	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	33,671,888	23,712,950
Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit	2	138,464,628	136,398,473
Të tjera	2	19,135,683	19,035,683
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	3	89,743	110,961
Totali i aktiveve afatshkurtra		191,361,943	179,258,067
Aktive afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	4	41,019,620	44,482,042
Aktive afatgjata jo materiale	4		
Totali i aktiveve afatgjata		41,019,620	44,482,042
Totali i aktiveve		232,381,563	223,740,109
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	6	0	1,013,421
Parapagimet e arkëtuara	5	692,057	971,192
Të pagueshme ndaj furnitorëve	5	41,559,198	53,364,963
Të pagueshme ndaj punonjësve	5	0	614,579
Të pagueshme për detyrime tatimore	5	3,599,175	1,717,220
Të tjera të pagueshme	5	3,814,111	3,814,111
Totali i detyrimeve afatshkurtra		49,664,541	61,495,485
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		0	0
Të tjera të pagueshme		0	0
Totali i detyrimeve afatgjata		0	0
Totali i detyrimeve		49,664,541	61,495,485
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nënshkruar	7	140,587,000	140,587,000
Rezerva ligjore	7	14,058,700	14,007,726
Rezerva të tjera	7	3,020,346	3,020,346
Fitimi/(humbja) e pashpërndarë	7	4,578,576	
Fitimi/(humbja) e periudhës	13	20,472,400	4,629,550
Totali i kapitalit		182,717,022	162,244,624
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		232,381,563	223,740,109

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 17 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i shoqërisë më 26/03/2025 dhe janë firmosur si në vijim nga:

Hartuese e Pasqyrave Financiare
Ardiana Peposhi
 Ardiana Peposhi



Administratore
Vjollca Hoxha
 Vjollca Hoxha

Pasqyra e Performancës (të ardhurave dhe shpenzimeve) sipas natyrës

	Shënimet	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		104,404,323	95,478,805
Të ardhura të tjera	8	3,871,924	8,882,436
Total të ardhura		108,276,247	104,361,241
Shpenzime të personelit	9	-42,410,885	-38,781,243
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	10	-11,893,611	-14,309,200
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	11	-26,806,376	-43,529,672
Total shpenzime		-81,110,872	-96,620,115
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	12	-17,088	-187,767
Shpenzime të tjera financiare (neto)	12	-1,874,928	-777,478
Fitimi/(humbja) para tatimit		25,273,359	6,775,881
Tatimi mbi fitimin e periudhës	13	-4,800,960	-2,146,330
Fitimi/(humbja) e periudhës		20,472,400	4,629,550

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 17 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hartuese e Pasqyrave Financiare
Ardiana Peposhi
 Ardiana Peposhi



Administratore
Vjollca Hoxha
 Vjollca Hoxha

Top Albania sh.a
 Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2024
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Pozicioni financiar më 1 Janar 2023

Kapitali i nenshkuar	Rezerva Ligjore	Rezerva te tjera	Fitimet/(humbjet) e pashpërndara	Fitim/(humbja) e periudhës	Totali
140,587,000	14,007,726	3,020,346	-4,383,994	9,956,094	163,187,173

Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:

Fitim/(humbja) e periudhës

Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën

Transaksione me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:

Dividend

Përcaktime të tjera për rezultatit e periudhës parardhëse

Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike

Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2023

-	-	-	-	4,629,550	4,629,550
-	-	-	0	-5,572,100	-5,572,100
-	-	-	4,383,994	-4,383,994	0
140,587,000	14,007,726	3,020,346	4,383,994	-9,956,094	-5,572,100
			0	4,629,550	162,244,624

Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:

Fitim/(humbja) e periudhës

Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën

Transaksione me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:

Dividend

Përcaktime të tjera për rezultatit e periudhës parardhëse

Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike

Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2024

0	0	0	0	20,472,400	20,472,400
0	0	0	0	0	0
50,974	50,974		4,578,576	(4,629,550)	-
-	50,974	-	4,578,576	(4,629,550)	-
140,587,000	14,058,700	3,020,346	4,578,576	20,472,400	182,717,024

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 17 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hartuese e Pasqyrave Financiare,
Ardiana Peposhi
 Ardiana Peposhi



Administratore
Vjollca Hoxha
 Vjollca Hoxha


Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare (metoda indirekte)

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Fluksi mjeteve monetare nga aktiviteti i shfrytëzimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhës	20,472,400	4,629,550
Regullime për shpenzimet jo-monetare:		
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jo-monetar	4,800,960	2,146,330
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,607,428	9,370,109
Zhvlerësimi i të drejtave të arkëtueshme	2,286,183	4,939,091
Shpenzime të konstatuara	0	13,171,478
Ndryshim në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit		
Rënie/(Rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-4,452,338	-2,386,712
Rritje/(Rënie) në detyrime të pagueshme	-15,618,483	-8,371,704
Rënie/(Rritje) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	21,218	4,911,890
Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit	<u>17,117,367</u>	<u>28,410,033</u>
Mjete monetare neto nga aktiviteti i investimit	<u>-6,145,006</u>	<u>-10,230,528</u>
Fluksi i mjeteve monetare nga aktiviteti i financimit		
Pagesa e huave	-1,013,422	-1,711,117
Dividend të paguar	0	-5,572,100
Mjete monetare neto nga aktiviteti i financimit	<u>-1,013,422</u>	<u>-7,283,217</u>
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	<u>9,958,939</u>	<u>10,896,288</u>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të periudhës	23,712,950	12,816,662
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të periudhës	<u>33,671,839</u>	<u>23,712,950</u>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 17 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Hartuese e Pasqyrave Financiare
Ardiana Peposhi
 Ardiana Peposhi

Administratore
Vjollca Hoxha
 Vjollca Hoxha



Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare

A. Informacion i përgjithshëm

TOP ALBANIA (Shoqëria) është krijuar si SH.A, më datë 16/05/2000 dhe e ka Selinë në adresën: Sheshi Italia, Arena Center, Hyrja D, Zona e zyresnr. "DC", nivel L+3, Tiranë.

Administrator i Shoqërisë është Zj. Vjollca Hoxha.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: Veprimtari radiofonike që përfshin prodhimin, transmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun.

Struktura e aksionerëve të shoqërisë si më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 është si më poshtë:

	31.12.2024	31.12.2023
Itan Hoxha	10%	10%
Lorela Hoxha	10%	10%
Sara Hoxha	10%	10%
Redia Hoxha	10%	10%
Zhuljeta Lamaj	20%	20%
Ervin Zeneli	40%	40%
	<u>100%</u>	<u>100%</u>

Numri mesatar i punonjësve 36 (2023:35 punonjës)
Referuar Nenit 4 të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare TOP Albania sh.a. kategorizohet në: njësi ekonomike e vogël. Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2024-31.12.2024.

B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKKP) dhe Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2023.

Qëndrueshmëria e paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

- **Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve apo debitorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve apo debitorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së tyre. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël nëse ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

- **Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

C. Politikat kryesore kontabile

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivet dhe pasivet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të perdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë:

<u>Kurset e këmbimit</u>	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
EUR/Lek	98.15	103.88
USD/Lek	94.26	93.94
GBP/Lek	118.16	119.47

2. Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër. Instrumentat financiarë të shoqërisë përbëhen nga: mjetet monetare; depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësia ekonomike është depozituesi [psh llogaritë bankare]; letra tregtare dhe kambiale tregtare; llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme; obligacione dhe instrumenta të ngjashme borxhi; zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare mjetet monetare.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

Llogaritë e arkëtueshme, tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen apo përfundojnë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël, Shoqëria nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

Netimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiar netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvlerësime të aktiveve jo - financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo - financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivitet tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ç`regjistrimi i instrumentave financiare

Aktivitet financiar se bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivitet financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Detyrimet financiar çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Inventarët

Inventarët (nëse ka) regjistrohen në kontabilitet me kosto e marrjes e cila përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Për përcaktimin e koston së inventareve është zgjedhur metoda e koston mesatare.

4. Aktivitet Afagjate Materiale (AAM-t)

Njohja dhe matja: Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja Mëpasshme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston së elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të kostos aktuale të kësaj pjese minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve shoqëria ka përcaktuar si metodë të amortizimit të AAM-ve metodën e amortizimit mbi bazën e metodes lineare ndërsa normat e amortizimit qëjanë përdorur janë normat fiskale si më poshtë:

Llojet e Aktiveve të Qendrueshme	Normat e aplikuar	Metoda e aplikuar
Ndertesa	5%	Metoda Lineare
Makineri dhe pajisje	20%	Metoda Lineare
Mjete transporti	20%	Metoda Lineare
Mobilje dhe Orendi	15%	Metoda Lineare
Pajisje Informatike	20%	Metoda Lineare
Te tjera	15%	Metoda Lineare

Toka dhe Investimet në proces nuk amortizohen.

Referuar ndryshimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr.29/2023, datë 30.09.2023, për Tatimin mbi të Ardhurat, kosto historike për aktivet afatgjata materiale të blera para datës 01.01.2024 do të konsiderohet vlera e mbetur e tyre deri ne datë 31.12.2023.

Ç`regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç`regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivët Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat dhe të drejtat për përdorim.

Njohja dhe Matja: Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amotizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të trupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

5. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

7. Dividendë

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e Shoqërisë njihet në pasqyrat financiare si detyrim i periudhës në të cilën janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

8. Kapitali i Vet

Kapitali i nënshkruar përfaqëson kontributin e aksionerëve në datën e krijimit të shoqërisë dhe ndryshimet gjatë veprimtarisë. Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

9. Grantet

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe shoqëria do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të shoqërisë, njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

10. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë mallit/shërbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

Shpenzimet

Shoqëria njih shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i shoqërisë.

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

11. Tatimi mbi fitimin

Tatim mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023 15%).

12. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

13. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetëm në shënimet shpjeguese, për sa kohë që mundësia e një daljeje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Vlera e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që, një detyrim ka lindur në datën e raportimit financiar, dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

14. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë të shoqërisë, në datën e bilancit kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

D. Shënimet për Pozicionet Financiare

1. Mjetet Monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqiten si në vijim:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Mjete monetare në bankë	33,628,168	23,626,155
Mjete monetare në arkë	43,720	86,795
Totali	<u>33,671,888</u>	<u>23,712,950</u>

2. Të drejta të arkëtueshme

Gjendja e llogarive të arkëtueshme e të tjera arkëtueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Klientë	147,994,053	143,641,715
Zhvlrësim i llogarive të arkëtueshme	-9,529,425	-7,243,242
Totali	<u>138,464,628</u>	<u>136,398,473</u>

Lëvizja në zhvlrësimin e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Gjendja më 1 Janar	7,243,242	3,681,992
Rimarrje gjatë vitit		
Zhvlrësim i llogarive të arkëtueshme gjatë vitit	2,286,183	3,561,250
Gjendja më 31 Dhjetor	<u>9,529,425</u>	<u>7,243,242</u>

Të tjera të arkëtueshme

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Paradhënie për punonjësit	874,158	874,158
Të drejta ndaj aksionerëve TVSH	15,756,325	15,756,325
Hua të dhëna	1,213,000	1,213,000
Të tjera	1,292,200	1,192,200
Totali	<u>19,135,683</u>	<u>19,035,683</u>

3. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Gjendja e parapagimeve dhe shpenzimeve të shtyra më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Parapagime për furnizime	89,743	110,961
Totali	<u>89,743</u>	<u>110,961</u>

4. Aktive Afatgjata Materiale dhe Jomateriale

	Ndërtesa	Impiante dhe makineri	Mjete transporti	Të tjera aktive të qëndrueshme	Totali
Vlera Bruto					
31 Dhjetor 2023	0	144,381,776	7,516,268	77,571,855	229,469,899
Shtesa		3,116,935	0	1,694,928	4,811,864
Pakësime					
31 Dhjetor 2024	0	147,498,712	7,516,268	79,266,783	234,281,763
Amortizimi i Akumuluar					
31 Dhjetor 2023	0	122,239,599	6,376,274	56,371,983	184,987,857
Shtesa		4,498,643	114,000	3,547,643	8,160,286
Pakësime	0		114,000		114,000
31 Dhjetor 2024	0	126,738,243	6,604,274	59,919,626	193,262,143
Vlera Neto					
31 Dhjetor 2023	0	22,142,177	1,139,994	21,199,872	44,482,042
31 Dhjetor 2024	0	20,760,469	911,994	19,347,157	41,019,620

	Patenta, licensa, makra tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme	Totali
Vlera Bruto		
31 Dhjetor 2023	440,428	440,428
Shtesa		
Pakësime	-440,428	
31 Dhjetor 2024	0	0
Amortizimi Akumuluar		
31 Dhjetor 2023	440,428	440,428
Shtesa	-440,428	
Pakësime		
31 Dhjetor 2024	0	0
Vlera Neto		
31 Dhjetor 2023	0	0
31 Dhjetor 2024	0	0

Top Albania sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. Detyrime Afatshkurtra

Llogaritë e pagueshme më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Parapagime të arkëtuara	692,057	971,192
Të pagueshme ndaj furnitorëve	41,559,198	53,364,963
Të pagueshme ndaj punonjësve		614,579
Të pagueshme për detyrime tatimore	3,599,175	1,717,220
Të tjera të pagueshme	3,814,111	3,814,111
Totali	49,664,541	60,482,064

Të pagueshme për detyrime tatimore

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	671,240	603,736
Tatim mbi të ardhurat personale	169,545	125,881
TVSH	193,888	370,093
Tatim mbi fitimin	2,555,827	166,923
Tatim në burim	8,672	450,587
Totali	3,599,171	1,717,220

6. Detyrime për Hua

Huatë afatshkurtra më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 përfaqësojnë vlerën e marrë hua nga Institucionet financiare Banka.

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Hua bankare	0	1,013,421
Totali	0	1,013,421

7. Kapitali

Më 31 Dhjetor 2024 kapitali aksionar i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën 140,587,000 Lek (31 Dhjetor 2023: 140,587,000 Lek).

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga aksionerët:

				<u>31.12.2024</u>
	Nr.Pjesëve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit	Kapitali i aksionar
Itan Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Lorela Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Sara Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Redia Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Zhuljeta Lamaj	28,117	1,000	20%	28,117,000
Ervin Zeneli	56,235	1,000	40%	56,235,000
	140,587		100%	140,587,000

				<u>31.12.2023</u>
	Nr.Pjesëve	Vlera nominale e aksionit	Struktura e Kapitalit	Kapitali i aksionar
Itan Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Lorela Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Sara Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Redia Hoxha	14,059	1,000	10%	14,058,750
Zhuljeta Lamaj	28,117	1,000	20%	28,117,000
Ervin Zeneli	56,235	1,000	40%	56,235,000
	140,587		100%	140,587,000

Rezervat ligjore të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 janë në vlerë 14,058,700 Lek (31 Dhjetor 2023: 14,058,700Lek). Revrvat e tjera të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 janë në vlerën 3,020,346 Lek (31 Dhjetor 2023: 3,020,346 Lek).

Top Albania sh.a
 Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2024
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)

8. Të ardhura nga veprimtaria e shfrytëzimit

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Të ardhura nga reklamat dhe shërbime të ndryshme	104,404,323	95,478,805
Të ardhura të tjera	3,871,924	8,882,436
Totali	108,276,247	104,361,241

9. Shpenzimet e personelit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Shpenzimet për paga	37,670,967	34,547,332
Shpenzime për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	4,739,918	4,233,911
Totali	42,410,885	38,781,243

10. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Shpenzime amortizimi	8,274,286	9,370,109
Zhvlerësim klientë	3,619,325	4,939,091
Totali	11,893,611	14,309,200

11. Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit

Në këtë zë përfshihen shpenzimet si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2024</u>	<u>31 Dhjetor 2023</u>
Blerje energji	4,842,957	4,951,392
Shpenzime qiraje	7,915,467	8,236,455
Mirëmbajtje dhe riparime	770,970	230,468
Sigurime	122,385	69,574
Shpenzime për materiale pastrimi	7,333	
Shpenzime për kancelari	13,284	167,845
Shërbime marketing, reklame dhe të tjera	5,254,537	5,209,588
Shpenzime për telefoni dhe internet	304,498	302,835
Shpenzime karburanti dhe transporti	14,967	
Shpenzime për shërbimet bankare	195,770	194,521
Taksa dhe tarifa vendore e të tjera të ngjashme	496,435	461,056
Taksa e regjistrimit AMA	1,831,600	1,791,600
Shpenzime të tjera për personelin dhe pritje përcjellje	2,874,778	2,479,805
Gjoha dhe dëmshpërblime	46,243	51,471
Shpenzime të tjera	2,115,152	19,383,061
Totali	26,806,376	43,529,672

Top Albania sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2024
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe)

12. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	17,088	187,767
Humbje nga këmbimet dhe përkthimet valutore	1,874,928	777,478
Totali	1,892,016	965,245

13. Rezultati Tatimor dhe Fitimi /(humbja) i vitit ushtrimor

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	25,273,359	6,775,881
Shpenzime të panjohura	6,733,037	7,532,987
Fitimi fiskal	32,006,397	14,308,867
Tatim fitimi (15 %)	-4,800,960	-2,146,330
Fitimi - (Humbje) Neto	20,472,400	4,629,550

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime të panjohura	2,953,470	2,542,425
Humbje nga mosarketimi i klientëve	1,333,142	
Humbje nga zhvlerësimi i klientëve	2,286,183	4,939,091
Gjoha dhe dëmshpërblime	46,243	51,471
Shp. nga amortizimi i automjeteve (i panjohur sipas ligjit 26/2023)	114,000	
Totali	6,733,037	7,532,987

14. Palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 Dhjetor 2024 dhe 31 Dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024		31 Dhjetor 2023	
	Të arkëtueshme	Të Pagueshme	Të arkëtueshme	Të Pagueshme
Top Channel sh.a	18,139,114		16,874,873	
Digit Alb Sh.a	3,054,280	2,257,015	7,332,628	8,198,682
VGA sh.p.k	1,192,328		1,075,557	
Valtelina sh.p.k	11,624,108		10,192,143	
Top Gold	834,800		618,800	
Aksionerët	15,756,324		15,756,324	3,814,111
	50,600,953	2,257,015	51,850,325	12,012,793

	31 Dhjetor 2024		31 Dhjetor 2023	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Top Channel sh.a	3,145,840	381,600	4,987,218	1,581,600
Digit Alb Sh.a	9,657,035	5,811,556	9,389,902	6,175,671
VGA sh.p.k	116,772	0	337,323	800,000
Valtelina sh.p.k	1,431,963	0	1,544,809	
Top Gold	216,000	0	144,000	
	14,567,610	6,193,156	16,403,252	8,557,271

Informacione të tjera	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Administrator	<u>2,055,336</u>	<u>2,055,336</u>
	<u>Nr</u>	<u>Nr</u>
Administrator	1	1
Këshill Mbikqyrës	7	7

15. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Më 31 Dhjetor 2024 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

16. Kontrollë tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 31.12.2024. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

17. Ngjarje pas datës së bilancit

Më 31 Dhjetor 2024 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për t'u paraqitur në këto pasqyra.

Hartuese e Pasqyrave Financiare
Ardiana Peposhi
Ardiana Peposhi



Administratore
Vjollca Hoxha
Vjollca Hoxha

Tiranë, më 26/03/2024